



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punëdhësi/Prodator Received/Delivered	30.03.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednitsa Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Dodog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHCK	1710/2022		1/17



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 42 /2022

Datë:30.03.2022

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, si dhe nenin 2 paragrafi 5 të Rregullores Nr.02/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.04/2018, Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*Këshilli*) në mbledhjen e pestë (V) të mbajtur më datë 30.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Raporti i Kolegjit të Këshillit lidhur me vlerësimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për vitin 2020 në Agjencinë e Kosovës për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës.
2. Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës obligohet për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandime është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.


Jeton KOCA
Kryetar i Këshillit

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë së Kosovës për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës
- Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës
- Arkivit të Këshillit.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery		30.03.2022		2 viti god year	
Organ /Rjeshtja Organ /Jedinstvo Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
STANSHOK	1710/2022		1196		



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MONITORIMIT
PËR VITIN 2020

në

AGJENCINË E KOSOVËS PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS

Prishtinë, 2022

1 / 16

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBAJTJE.....	2
HYRJE.....	3
FUNKSIONI I MONITORIMIT.....	3-4
OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT.....	4
FUSHA E MONITORIMIT.....	4-5
RAPORTI I MONITORIMIT NË AGJENCINË E KOSOVËS PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS.....	5-16

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tutje referuar si Këshilli*) është institucion i themeluar me Kushtetutë, me mandat specifik për sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

Këshilli, mandatin e tij kushtetues, *sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil* e realizon përmes funksioneve themelore të përcaktuara me nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si:

- ❖ *shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidateve për pranim në shërbimin civil;*
- ❖ *monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.*

Këshilli, funksionet dhe përgjegjësitë themelore i ushtron në pajtim me:

- ❖ *Kushtetutën e Republikës së Kosovës;*
- ❖ *Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- ❖ *Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë;*
- ❖ *Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;*
- ❖ *Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;*
- ❖ *Rregulloren Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- ❖ *Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- ❖ *Rregulloren Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.*
- ❖ *Rregulloren Nr.05/2018, Për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës*

FUNKSIONI I MONITORIMIT TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE

Krahas funksionit të shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave të nëpunësve civil dhe kandidateve për pranim në shërbimin civil, Këshilli ushtron edhe funksionin e monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Ketë funksion e ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe dispozitat e Rregullos Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit në Institucionet e Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

Këshilli, përmes ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike, mbikëqyrë zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit

për shërbimin civil me qëllim të krijimit të një administratë publike, profesionale dhe efikase, sipas standardeve me të mira evropiane.

Funksioni i monitorimit ushtrohet përmes monitorimit të rregullt që realizohet sipas planit vjetor të monitorimit, dhe përmes monitorimit të jashtëzakonshëm që realizohet në raste të veçanta që ndërlidhen me shkelje të rënda të legjislacionit për shërbimin civil.

Këshilli, në procesin e monitorimit të institucioneve të administratës publike përgatit raport me të gjetura dhe rekomandime dhe nxjerr vendim, të cilin së bashku me raport ia dërgon institucionit përkatës. Institucioni përkatës i administratës publike është i obliguar për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit, brenda afatit të përcaktuar me vendimin e Këshillit.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Përmes ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike Këshilli siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave për realizimin e objektivës sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

FUSHAT E MONITORIMIT

Këshilli, me qëllim të ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e monitorimit.

Sipas Rregullores Nr.04/2018 për procedurën e monitorimit në institucionet e administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, fushat të cilat monitorohen nga Këshilli janë:

- ❖ Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- ❖ Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- ❖ Procedurat disiplinore;
- ❖ Procedurat e ankesave;
- ❖ Procedurat e vlerësimit;
- ❖ Procedurat e pushimeve;
- ❖ Procedurat e transferimit;
- ❖ Të dhënat lidhur me përfaqësimin etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- ❖ Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- ❖ Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- ❖ Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale apo është i dënuar me vendim të gjykatës;
- ❖ Trajnimi i nëpunësve civil;
- ❖ Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- ❖ Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- ❖ Ngacmimet Seksuale;

❖ Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Monitorimin e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil

RAPORTI I PROCEDURËS SË MONITORIMIT LIDHUR ME ZBATIMIN E RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL, NË AGJENCINË E KOSOVËS PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS

Këshilli, gjatë procesit të monitorimit së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Agjencinë e Kosovës për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, për të vlerësuar drejtë në mënyrë të pa anshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Agjencia e Kosovës për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, përveç monitorimit të drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës në Agjencinë e Kosovës për Krahasim dhe Verifikim të Pronës të realizuar me datë 12.04.2021 dhe 28.04.2021, në prezencë të Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim:

Rregullorja Nr.01/2012 për Standardizimit e Organizimit të Brendshëm dhe Klasifikimit Sistematizimin e Vendeve të Punës, Agjencisë Kosovare të Pronës, Struktura organizative e AKKVP-së, Lista e nëpunësve civil për vitin 2020 në Agjencinë e Kosovës për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, Raporti vjetor i Burimeve Njerëzore, për vitin 2020, Lista e Ushtruesve në Detyrë për vitin 2020, Zëvendësuesve dhe Transfereve, Lista e të punësuarve me Marrëveshjet për shërbime të veçanta për vitin 2020, Dosja e procedurës së rekrutimit për vitin 2020, për pozitat e nëpunësve civil: dy (2) pozita "Asistent Administrativ 3", në Zyrën Regjionale në Pejë, konkursi i shpallur me datë 13.09.2019, Njoftimi i datës 28.09.2019, për vazhdimin e afatit të konkursit edhe për 7 ditë duke filluar nga data 04.10.2019, Njoftimi i datës 08.10.2019, lidhur me pezullimin e procedurës së rekrutimit të jashtëm sipas MAP-it, deri në miratimin e rregullores për zbatim të Ligjit Nr.06/L-114 për zyrtarët publik, Njoftimi i datës 08.10.2019 për kandidatet që kanë aplikuar në këtë pozitë, Njoftimi Nr.34 i datës 10.01.2020 nga MAP për zbatimin e Ligjit Nr.03/L-149 për shërbimin civil dhe rregulloren në fuqi, Njoftimi i datës 22.01.2020, për vazhdim të procedurës së rekrutimit pas pezullimit, Vendimi nr. ref.:00068/20/d.j i Komisionit Rekrutues i datës 22.01.2020, i ndryshuar me Vendimin nr.iref.:00082/20/d, Deklarata me shkrim e datës 24.01.2020 për mos arritjen e përmbushjes së kriterit etnik të komisionit rekrutues, Njoftimi i datës 23.01.2020 për kandidatet, Deklarata e datës 28.01.2020 e besueshmërinë dhe paanësisë për anëtarët e panelit rekrutues, Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen e listës së ngushtë i datës 28.01.2020, bashkangjitur lista e ngushtë, Përcaktimi i kriterëve për testim me shkrim dhe me gojë, i datës 28.01.2020, ftesa për test me shkrim e-maili i datës 28.01.2020 për kandidatët, Raporti i komisionit rekrutues i datës 03.02.2020, pas testit me shkrim, Ftesa-intervistë me gojë i datës 03.02.2020, Formulari i vlerësimit individual të kandidatëve-MAP-SHCK-08a, Renditja përfundimtare e kandidatëve i datës 06.02.2020, Raporti final i Komisionit rekrutues, i datës 07.02.2020 nga Komisioni rekrutues, për propozimin e kandidatëve të suksesshëm për dy vendet e punës Asistent administrativ 3 në zyrën regjional të Pejës, Emaili i datës 11.02.2020, për kandidatët, Vendimi nr.ref.:00173/20/d.j. dhe Vendimi nr.ref.:00174/20/d.j i datës 13.02.2020 për pranim në marrëdhënien e punës, i nxjerrë nga Drejtori Ekzekutiv i Sekretariatit të AKKVP-së, Dosja e procedurës së rekrutimit për vitin 2020, për marrëveshje për shërbime të veçanta, pozita "Zyrtar për siguri dhe mbrojtje në punës", në Zyrën Regjionale në Pejë, i shpallur me datë 14.02.2020 deri me

datë 21.02.2020, Vendimi nr.ref.:00214/20/dj, i datës 24.02.2020, për themelimin e komisionit rekrutues, Deklarata e datës 25.02.2020 e besueshmërinë dhe paanësisë për anëtarët e panelit rekrutues, Përcaktimi i kriterëve përfundimtare të përzgjedhjes i datës 25.02.2020, Formulari i datës 25.02.2020 për krijimin e listës së ngushtë, Ftesa për intervistë E-maili i datës 25.02.2020, Formulari i pyetje nga intervista me gojë i datës 27.02.2020, Forma e vlerësimit individual të kandidatëve, Përmbledhja e vlerësimeve individuale, Renditja përfundimtare e kandidatëve, i datës 27.02.2020, Raporti final i rekomandimit nga komisioni rekrutues i datës 27.02.2020, Rekomandimi i datës 27.02.2020 për emërimin e kandidates për pozitën 'Zyrtar për siguri dhe mbrojtje në punës, në Zyrën Regjionale në Pejë dhe E-maili i datës 28.02.2020, njoftimi i kandidates së përzgjedhur nga rezultati i intervistës, Lista e nëpunësve civil për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, me rastin e pensionimit, me dorëheqjes dhe me rastin e vdekjes, për vitin 2020, të bashkangjitur dokumentacionin si mostër, Vendimi me numër Ref:00543/19/shs, për emërimin e Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, i datës 15.05.2019, Vendimi me numër Ref:01132/19/dj, për shuarjen e Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, i datës 15.10.2019, Vendimi me numër Ref: 00102/20/shs, për emërimin e Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, i datës 31.01.2020, Vendimi nr. Ref:00453/208dj, për shuarjen e Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, i datës 02.07.2020, Vendimi i datës 12.03.2019 Ref:00256/19/shs për vazhdimin e emërimit të Komisionit Disiplinor, Vendimi i datës 15.10.2019 Ref: 01130/19/dj për shuarjen e Komisionit Disiplinor, Vendimi i datës 21.03.2019 Ref:01131/19/dj, për emërimin e Komisionit Disiplinor, Vendimi i datës 01.04.2021 Ref:00289/21/shs, për ndryshim, plotësim të Komisionit Disiplinor, Lista e nëpunësve civil pushimeve, të lehonisë, pushimi pa pagesë dhe mjekësore për vitin 2020, Lista e nëpunësve civil për kompensimin për punë jashtë orarit, për vitin 2020, Lista e pagave për nëpunësit civil nga viti 2020, Lista e pagave për muajin dhjetor për vitin 2020, Lista /Formulari përmbledhës i nëpunësve civil të vlerësuar me notat , 3,4 dhe 5 për vitin 2020, Plani i trajnimve për nëpunësit civil 2020, i datës 01.03.2021, Lista e Ushtruesve në detyrë për vitin 2020, dosjet e ushtruesve në detyrë, pasqyra e pagave për nëpunësit civil, në pozitës "Udhëheqës i Departamentit", "Udhëheqës të zyreve regjionale", "Zyrtareve ligjor", "Zyrtar i larte per perkthime", "Zyrtar per zhvillimin e BNJ", z.I.O, znj.M.E.S, z.Sh.B, z.M.C., z.V.G., z.A.I, z.V.K., znj.A.K., znj.M.M.", z.D. J., Lista e kompensimit jashtë orarit për nëpunësve civil për vitin 2020, bashkangjitur kërkesën dhe vendimin, Raporti i Auditimit të Brendshëm në Agjencinë e Kosovës për Krahësim dhe Verifikim të Proës për viin 2020, Njoftim(Email) i datës 11.03.2020, lidhur me Vendimet e nxjeruara nga Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, Vendimi nr.i Ref.:00239/20 i dates 28.02.2020, i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, Njoftim(Email) i datës 02.03.2020, për ankusen dhe njësin e prsonelit lidhur me nxjerrjen e Vendimit të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Njoftim(Email) i datës 10.03.2020, për ankusen dhe njësin e personelit lidhur me nxjerrjen e Vendimit të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave,(korigjim),Procesverbali nr.ref.:00128/20/vg i dates 05.02.2020 Procesverbali nr.ref.:00236/20/vg i dates 08.02.2020 dhe Procesverbali nr.ref.:00238/20/ai i dates 13.02.2020, bashkangjitur E-mailat dhe duke përfshië kërkesën e ankueses, deri tek nxjerrja e vendimit, fteses për seancën e zhvilluar nga Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, si dhe Fletëdorëzimi i datës 02.03.2020 dhe i dates 10.03.2020, Shkresë zyrtare e datës 09.03.2020, lidhur me njoftimin e ankueses per korigjim të vendimit të datës 28.02.2020, Vendimi nr.174 i dates 04.10.2017, me Raport

nga mbikqyrja e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për Agjencinë e Kosovës për Krahësim dhe Verifikim të Proës për viin 2017, E-mail i datës 23.12.2021 lidhur me deklarinë e statusit të zyrtarëve publik, Vendimi NR.Ref.00864/20/shs - Deklarimi i statusit të zyrtarëve publik me datën 26.10.2020, të bashkangjitur Listën e nëpunësve civil në Agjencinë e Kosovës për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, dhe Kontrata e punës e datës 27.11.2020, Ndryshimi dhe plotësimi të akt emërimit me datë 15.01.2021.

Këshilli për procedurën e monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e monitorimit të përfshira në "pyetësor", ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim:

1. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Këshilli për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për Shërbimin Civil, gjatë vizitës që ka bërë në Agjencinë e Kosovës për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, për viin 2020, me datë 12.04.2021 dhe me datë 13.04.2021, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren Nr.01/2012 për Standardizimet e Organizimit të Brendshëm dhe Klasifikimit, Sistematizimin e Vendeve të Punës, të Agjencisë Kosovare të Pronës. Në këtë institucion janë 200 pozita të nëpunësve civil të miratuar me buxhet, ndërsa 14 pozita janë të lira.

Gjatë vizitës së monitorimit, Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka shqyrtuar dosjet e personelit dhe ka konstatuar se janë shqyrtuar pesë (5) dosje të nëpunësve civil ndërsa si kopje janë marrë dy (2) dosje, për pozitën "Udhëheqës i Burimeve Njerëzore" dhe pozita "Zyrtarit Financiar", në bazë të shqyrtimit të dosjeve është konstatuar që dosjet e personelit kanë qenë të kompletuara në bazë të dispozitave ligjore të Rregullores Nr. 03/2011 mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendror të Nëpunësve Civilë, me përjashtim se në dosje nuk gjendet formulari i përmbajtjes së dosjes.

Pozitat e Ushtruesve të detyrave: Kolegji gjatë monitorimit është bazuar në dëshmitë e ofruara të Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore, dhe ka konstatuar se në këtë institucion ka pasur tetë (8) pozita me ushtrues detyre dhe pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, që të gjitha janë vazhduar me zëvendësues në detyrë deri me datë 30.09.2020, për shkak të mungesës së aprovimit të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Organogramin, nuk kanë zhvilluar procedura të rekrutime, dhe kanë qenë duke zhvilluar aktivitetet për funksionalizimin e rekrutimit/miratimit të Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës.

Bazuar në deklarinë e Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, e cila ka deklaruar se është dërguar deklarimi i statusit të zyrtarëve publikë, në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe është nxjerrë Vendimi me nr.Ref.00864/20/shs për deklarimin e statusit të nëpunësve civil, bazuar në nenin

83 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrat Publike dhe në Rregullorën (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtareve Publik.

E GJETURA 1: Këshilli për monitorim rrethë zbatimit të legjislacionit për Shërbimin Civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve të personelit, ka konstatuar që dosja e ushtruesve në detyrë/ zëvendësime në detyrë për vitin 2020, kanë qenë tetë (8) pozita, për pozitën 1. "Zv.Kryesuesi i TI-së", 2."Zv.Udhëheqës i Buxhetit dhe Financave", 3. " U.d.Kryesekretare e Njësisë së Implementimit", 4."Zv.Kryesekretar", 5."UD.Udhëheqës i Njësisë së Informimit", 6. "Zv,Kryesues i Njësisë për Zbatim", 7. "Zv.Kryesues i Zyres Regjionale në Pejë", 8."Zv.Kryesues i Zyres Regjionale në Gjirokastrë", lidhur me vazhdimin e pozitave me ushtrues në detyrë dhe zëvendësuesve, Udhëheqësja e Njësisë së Burimeve Njerëzore, deklaroi se nuk kanë pasur procedura të rekrutimit të lejuara në periudhën e vitit 2020, dhe për këtë arsyeje janë bërë këto zëvendësime.

Këshilli për monitorim, lidhur me dosjen e nëpunësve të caktuar për ushtrimin e detyrës dhe zëvendësuesve, pas monitorimit të dosjeve mbi zbatimin e procedurave të zhvilluara për ushtruesit në detyrë/zëvendësuesve, është konstatuar se ushtruesit në detyrë janë caktuar në mungesë të stafit, kurse dosjet e tyre janë të renditura pjesërisht sepse gjatë monitorimit është gjetur se në dosje gjenden pjesërisht të vendosura formularët e përmbajtjes së dosjes personale të nëpunësit civil, kurse shkresat e tjera dhe formularët e vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2020 janë vendosur në dosje të personelit Andaj, në bazë të këtyre që gjeturave Kolegji vlerëson se janë respektuar pjesërisht dispozitat e nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1 dhe 1.17 të Rregullores Nr.03/2011 mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendror të Nëpunësve Civil, dhe dispozitat e nenit 4 paragrafit 3 të Rregullores (MPB) Nr. 01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, respektivisht shtojcës 1.1 pika 17 të kësaj rregulloreje, sepse dosja personale e zyrtarit publikë duhet të shoqërohet nga fleta prezantuese e krijuar nga zyrtari përgjegjës i Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, e cila ka formën dhe përmbajtjen sipas shtojcës nr.1.2, ndërsa Fleta prezantuese sipas paragrafit 3 të këtij neni nënshkruhet nga zyrtari i autorizuar i njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit përkatës dhe nga vetë zyrtari publik, për të cilin është krijuar dosja personale, e përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni. Po ashtu dosjet e personelit duhet të jenë të kompletuara, sipas përmbajtjes që kërkohej në shtojcën 1.1 të kësaj rregulloreje.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Udhëheqësin e Njësisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për eliminimin e shkeljes së lartcekur, që të gjitha dosjet e personelit të jenë në pajtim me dispozitat e Rregullores (MPB) Nr.01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

E GJETURA 2: Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimit me Ref.00467 të datës 25.05.2017, për caktimin ushtrueses në detyrë të nëpunëses civile, prej pozitës "zyrtare e lartë ligjore", në pozitë "U.D.Kryesekretare e Njësisë së Implementimit", i cili vendim është nxjerre nga zv.Drejtori Ekzekutiv i AKKVP-së, dhe Vendimin me Ref.00181/20/shs të datës 14.02.2020, për caktimin ushtruesit në detyrë të nëpunësit civil nga pozita "Zyrtar Profesional, Zyra e

Komisionit për Kërkesa, Ekipi Mbështetës i KKP-së", në pozitë "UD.Udhëheqës i Njesisë së Informimit", i cili është vazhduar me datë 01.07.2020 duke e bërë zëvendësimin e kësaj pozite me zëvendësues, sipas Vendimit Ref:00464/20/dj, duke u bazuar në Ligjin Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

Mbi këtë bazë Këshilli konstaton se caktimi i ushtruesve në detyrë, në periudhë më të gjatë se 3 muaj është në kundërshtim me dispozitat e nenit 30 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe caktimi i zëvendësuesve është në kundërshtim me nenin 20 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, sepse në rastet kur mungon "Udhëheqësi i Divizionit", zëvendësohet nga nëpunësi civil i nivelit më të lartë i të njëjtit divizion, kurse për pozitën e "Drejtorit të Departamentit", në rast të mungesës së tij, zëvendësohet nga njëri/a nga pozitat e Udhëheqësit të Divizionit, në rast se ka më shumë se një nëpunës civil të të njëjtit nivel, ai zëvendësohet nga nëpunësi civil i nivelit më të lartë, që ka përvojë më të gjatë në Shërbimin Civil.

Rekomandimi 2: Rekomandojmë Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë së Kosovës për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme që të respektohen të gjitha afatet ligjore lidhur me caktimin e zëvendësuesve, ashtu siç parashihet në Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrat Publike, duke marrë për bazë që pozitat e nivelit drejtues të zëvendësohen nga nëpunësit civil, në pajtim me nenin 20 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura .

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për Shërbimin Civil, ka konstatuar se Agjencia e Kosovës për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, ka përgatitur planin e rekrutimit të personelit për vitin 2020, ndërsa për vitin 2020 është zhvilluar vetëm një procedurë e rekrutimit, për pozitën "Asistent Administrativ 3", në Regjionin e Pejës, edhe pse i kanë pasur 14 pozita të lira, me arsyetimin se në mungesë të aprovimit të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Organogramit, nuk kanë zhvilluar procedura të rekrutimit.

Siç potencuam më lartë në vitin 2020 është zhvilluar vetëm një procedurë e rekrutimit për pozitën "Asistent administrativ 3", në Zyrën Regjionale të Pejës, e cila është zhvilluar në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil. Konkursi është shpallur me datë 13.09.2019, i vazhduar nga data 04.10.2019 edhe për 7 ditë. Me njoftimin e datë 08.10.2019 është pezulluar procedura e rekrutimit të jashtëm sipas MAP-it, deri në miratimin e rregullorës për zbatim të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat Publike, sipas Njoftimi Nr.34 i datës 10.01.2020 nga MAP për zbatimin e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil dhe rregullorën në fuqi, Njoftimi i datës 22.01.2020, për vazhdim të procedurës së rekrutimit pas pezullimit, Vendimi nr. ref.:00068/20/dj i Komisionit Rekrutues i datës 22.01.2020, i ndryshuar me Vendimin nr.iref.:00082/20/d. Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen e listës së ngushtë i datës 28.01.2020, bashkangjitur lista e ngushtë. Përcaktimi i kriterëve për testim me shkrim

dhe me gojë, i datës 28.01.2020. Raporti i komisionit rekrutues i datës 03.02.2020, pas testit me shkrim, Ftesa intervistës me gojë i datës 03.02.2020, Formulari i vlerësimit individual të kandidatëve-MAP-SHCK-08a, Renditja përfundimtare e kandidatëve i datës 06.02.2020, Raporti final i Komisionit Rekrutues, i datës 07.02.2020 nga Komisioni rekrutues, për propozimin e kandidatëve të suksesshëm për dy vendet e punës "Asistent administrativ 3", në Zyrën Regjionale të Pejës, Vendimi nr.ref.:00173/20/d.j. dhe Vendimi nr.ref.:00174/20/d.j i datës 13.02.2020 për pranim në marrëdhënien e punës, për dy kandidatët e përzgjedhur, i nxjerrë nga Drejtori Ekzekutiv i Sekretariatit të AKKVP-së.

Në këtë institucion janë lidhur shtatë (7) kontrata me marrëveshje për shërbime të veçanta, të cilat janë të vazhduara me angazhim me këto periudha nga data 01.06.2011 deri me datë 30.06.2020, për të cilat Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore, deklaroi se janë zhvilluar procedurat e thjeshtësuara të rekrutimit, gjatë monitorimit dhe mostrave të marra është gjetur se pozita "Zyrtar për siguri dhe mbrojtje në punë", e shpallur me datë 14.02.2020 është pozitë e kategorisë së shërbimit civil, siç e përcakton dispozita e nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Në këtë fushë kemi konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 3: Kolegji për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për Shërbimin Civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve të punësuarve me marrëveshje për kryerjen e shërbimeve të veçanta, për vitin 2020 është zhvilluar një procedurë e rekrutimit me konkurs të hapur, dhe është konstatuar se në Agjencinë e Kosovës për Krahësim dhe Verifikim të Pronës për vitin 2020, ka pasur të angazhuar në vazhdimësi gjithsejtë shtatë (7) nëpunës, me këto periudha nga data 06.03.2018 deri me datë 30.06.2020 gjithsejtë katër (4) punonjës, kurse për periudhën nga data 01.01.2013 deri me datën 31.09.2020, gjithsejtë tre (3) nëpunës, prej të cilëve është gjetur se është zhvilluar procedura e rekrutimit në vitin 2020 për pozitën: "Zyrtar për Siguri dhe Mbrojtje në punë", me konkursin e datës 27.02.2020, të cilën Këshilli e ka marrë si mostër sepse vizita e monitorimit është zhvilluar për vitin 2020, dhe ka konstatuar se procedura është zhvilluar në pajtim me nenin 12 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 18 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, por pozita e rekrutuar e nivelit të kategorisë së karrierës nuk mund të përfshihet në procedurën e rekrutimit për marrëveshje me shërbime të veçanta nga se pozita nuk është pozitë e kategorisë së jo karrierës, por e njejtë është pozitë e karrierës sic përcakton Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i cili ka qenë në fuqi në këtë periudhë.

Andaj, gjatë monitorimit është marrë si mostër procedura e zhvilluar për pozitën "Zyrtar për siguri dhe mbrojtje në punë", në Zyrën Regjionale në Pejë, dhe është konstatuar se kjo pozita janë pozita të kategorisë së karrierës në shërbimin civil, siç e përcakton neni 12 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, për të cilat pozita është lidhur marrëveshje për shërbimeve të veçanta, në pajtim me nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me procedurë të rekrutimit dhe të cilat marrëveshje janë përfunduar me datë 30.09.2020, dhe i gjithë procesi është dashur të ndiqet sipas këtij ligji, mirëpo për angazhimin e këtyre marrëveshjeve nuk ka pasur

asnjë procedurë të zhvilluar të re të rekrutimit që ka qenë në kundërshtim me nenin 12 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Nga kjo rrjedh se shtatë (7) rastet e marrëveshjeve për shërbime të veçanta kanë qenë të lidhura për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj që ka qenë në kundërshtim me nenin 12 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Të gjitha këto marrëveshje janë lidhur për pozita të shërbyesve civil që kanë qenë në kundërshtim me legjislacionin për shërbimin civil sepse për pozita të shërbimit civil të karrierës nuk lidhen marrëveshje për shërbime të veçanta sepse këto marrëveshje lidhen vetëm për pozita specifike të jokarrieres që nuk mund të mbulohen me pozita të rregullat në shërbimin civil.

Rekomandimi 3: Rekomandojmë Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë së Kosovës për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, që procedurat për marrëveshjet për shërbimeve të veçanta, të zhvillohen duke u bazuar në nenin 84 të Ligjit nr. 06-L-114 për Zyrtarët Publik.

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Agjencia e Kosovës për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës në bazë të Vendimit të datës 21.03.2019 Ref:01131/19/dj, për emërimin e Komisionit Disiplinor, i cili është i themeluar prej tre (3) anëtarëve të përhershëm me mandat dy (2) vjeçar që është në pajtim me nenin 70 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në bazë të vlerësimeve në këtë institucion nuk ka të inkuar ndonjë procedur disiplinore.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Agjencia e Kosovës për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, në bazë të provave të marra nga vizita e monitorimit, Vendimi me numër Ref: 00102/20/shs, për emërimin e Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, i datës 31.01.2020, i cili është i themeluar me tre (3) anëtar të përhershëm me mandat dy (2) vjeçar që është në pajtim me nenin 82 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës në bazë të vlerësimeve në këtë komision gjatë vitit 2020 është parashtruar një(1) ankesë, dhe po ashtu është shqyrtuar dhe nxjerrja e Vendimit me Nr.ref.00239/20 i datës 28.02.2020 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe nuk kemi konstatuar të gjetur, sepse ankesa është shqyrtuar në pajtim me Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr.05/2011 për Procedurën e Zgjedhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Këshilli për monitorim e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Agjencia e Kosovës për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, është bërë brenda afatit të përcaktuar ligjor, punë për vitin 2020. Në këtë rast është konstatuar se vlerësimi i rezultateve të punës për të gjithë nëpunësit civil është bërë në pajtim me dispozitën ligjore të nenit 43 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe të Rregullore Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Këshilli për monitorim e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Agjencia e Kosovës për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, evidencën e pushimeve të nëpunësve civil e mban në kopje fizike dhe elektronike, por nëpunësit civil nuk kanë qasje për në sistemin elektronik SIMBNJ, lidhur me paraqitjen e kërkesës për pushim vjetor dhe të tjera.

E GJETURA 4: Këshilli për monitorim e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjes së nëpunësit në Agjencin e Kosovës për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, ka konstatuar se për të gjitha pushimet e nëpunësve civil mbahet evidencë fizike, nga Njësia e Burimeve Njerëzore, pushimet e nëpunësve të Agjencisë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, nuk procedohen përmes sistemit SIMBNJ-së për arsyeje se i kanë E-mailat jashtë rrjetit Qeveritar. Me qëllim të zbatimit të Ligjit Nr.06/-114 për Zyrtarët Publik, Njësia e personelit respektivisht Menaxherja e Burimeve Njerëzore, ka adresuar kërkesa tek Zëvendës Kryesuesi i TI-së që të bashkëpunoj me ASHI në mënyrë që të hapin e-mailët me @rks-gov.net, për të gjithë nëpunësit e Agjencisë, sepse i gjithë procesi i punës së BNJ-së do të kaloj përmes Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ). Të cilat kërkesa për krijimin e e-mailave zyrtar është adresuar në ASHI, por nuk kanë marrë përgjigjeje.

Rekomandimi 4: Rekomandojmë Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë së Kosovës për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, që të mbahen evidenca të gjitha llojeve të pushimeve për nëpunësit civil në formë elektronike SIMBNJ-së, si dhe të ju mundësohet nëpunësve civil qasja në sistem elektronik, SIMBNJ, për paraqitjen e kërkesave për llojin e pushimit, në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik si dhe Rregulloren (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë.

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Këshilli për monitorim e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Agjencia e Kosovës për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, gjatë vitit 2020, ka pasur 4 transferime të përkohshme.

Në bazë të shqyrtimit të dosjeve, konstatohet që janë respektuar procedurat e parapara me të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Këshilli për monitorim e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Agjencia e Kosovës për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, ka të punësuar 185 nëpunës civil, 170 janë Shqiptar dhe 15 të tjerë, Prej 185 të punësuarave 65 janë femra dhe 120 janë meshkuj, ndërsa nëpunës civil me nevoja të veçanta nuk kanë të deklaruar në këtë institucion.

E GJETURA 5: Këshilli për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për Shërbimin Civil, ka konstatuar se Agjencia e Kosovës për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, ka të punësuar 185 nëpunës civil, dhe nuk ka të punësuar asnjë person me aftësi të kufizuara, me çka nënkuptohet se nuk është respektuar dispozita e nenit 12 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, sipas të cilës dispozitë është përcaktuar që „Çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor”

REKOMANDIMI 5: Rekomandojmë Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë së Kosovës për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për respektimin e dispozitave të nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

E GJETURA 6: Këshilli për monitorim e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 185 nëpunësve civil të punësuar në Agjencinë e Kosovës për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, 65 janë të punësuar femra dhe 120 janë të punësuar meshkuj, çka nënkupton se nuk ka numër të barabartë të punësuarve në aspektin gjinor ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

Rekomandim 6: Rekomandojmë Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë së Kosovës për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e dispozitave të nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Këshilli për monitorim e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Agjencinë e Kosovës për Krahxim dhe Verifikim të Pronës, nuk kanë nëpunës me pezullim të dakorduar. Në bazë të vlerësimit të dosjeve një (1) nëpunës civil ka marrë pushim pa pagesë, dy (2) nëpunësve civil i është ndërprerë marrëdhënia e punës me dorëheqje, nuk kanë raste të shkarkimit nga detyra, ka pasur dy (2) raste të përfundimit të marrëdhënies së punës, për shkak të vdekjes së nëpunëses civile, një (1) me rastin e pensionimit.

Në bazë të vlerësimit të dosjeve, është konstatuar se një nëpunësve civil i është përfunduar marrëdhënia e punës në pajtim me legjislacionin për shërbimin civil, të cilit i është bërë pagesa e një page të njëhershme në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe akteve nënligjore, ndërsa nuk ka asnjë nëpunës civil që i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak (ushtrimit të detyrave për arsye shëndetësore, përfundimit të afatit për punësi me afat të caktuar, dënimit nga një gjykatë penale me vendim të formës së prerë).

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Këshilli për monitorim e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Agjencinë e Kosovës për Krahxim dhe Verifikim të Pronës, nuk ka asnjë nëpunës civil i cili në të njëjtën kohë mbanë ndonjë post publik.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Këshilli për monitorim e zbatimit të legjislacionit për Shërbimin Civil, ka konstatuar se në Agjencinë e Kosovës për Krahxim dhe Verifikim të Pronës, nuk kanë pasur raste të nëpunësve civil që është duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale .

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Këshilli për monitorim e zbatimit të legjislacionit për Shërbimin Civil, ka konstatuar se në Agjencinë e Kosovës për Krahxim dhe Verifikim të Pronës, respektivisht Njësia e Burimeve Njerëzore, e ka të përgatitur planin individual të trajnimeve në të cilin përfshihen fushat trajnimit (Formular 3) siç përcaktohet me Manualin e Metodologjisë së Vlerësimit të Nevojave për Trajnim në SHCK, dhe është proceduar në

DASHC/MAP. Po ashtu, mbanë evidencën e trajnimeve të nëpunës civil, dhe raporteve final nga BNJ.

Në bazë të dëshmive të ofruara, konstatohet që nëpunësit civil, marrin pjese në trajnime në bazë të ftesave nga Instituti i Kosovës për Administratën Publike, por gjatë periudhës së pandemisë CV-19, nuk ka pasur ftesa nga IKAP për mbajtjen e trajnimeve me pjesëmarrjen fizike të nëpunësve civil, për vitin 2020.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

13. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Këshilli për monitorim e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Agjencia e Kosovës për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, vijimin në punë e mban në formë elektronike përmes një programi të vetë agjencisë. Po ashtu në bazë të shqyrtimit të listës së pagave konstatohet se të gjitha pagat realizohen në pajtim me akt emërimet. Kurse nëpunësit civil në Komisionet për Vlerësimin e lëndëve kompenzohen për punë jashtë orarit konform Legjislacionit në fuqi.

E GJETURA 7: Këshilli për monitorim e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të qështjes së vijimit në punë ka konstatuar se agjencioni nuk ka sistem të evidentimit të vijimit në punë të nëpunësve civil, që aplikohet konformë legjislacionit në fuqi dhe menaxhohet nga DMZP-MPB.

Rekomandim 7: Rekomandojmë Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë së Kosovës për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, që të ndërmarr të gjitha veprimet me qëllim që të implementohet sistemi i vijimit në punë të zyrtarëve publik përmes sistemit elektronike të aprovuar nga DMZP-MPB, konformë Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë fushë.

14. NGACMIMET SEKSUALE

Gjatë vizitës së monitorimit nuk na është raportuar asnjë rast sa i përket kësaj çështje dhe nuk kemi ndonjë rekomandim.

15. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Këshilli për monitorim e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Agjencia e Kosovës për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, nuk ka pranuar vendime të Këshillit për vitin 2020, sepse nuk ka pasur ankesa dhe po ashtu as nxjerrje të vendimeve.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

**16. SHËNIMET/KOMENTET/KONKLuzionET E PËRGJITHSHËM PËR
PROCEDURAT E MONITORIMIT TË INSTITUCIONEVE TË ADMINISTRATËS
PUBLIKE LIDHUR ME ZBATIMIN E RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË
LEGJSLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL**

Këshilli gjatë shqyrtimit dhe inspektimit të të dhënave të dosjeve për fushat e monitorim, ka arritur të konstatoj shtatë (7) të gjetura dhe ka dhënë shtatë(7) rekomandime.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë së Kosovës për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, që gjetjet me rekomandimet e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Zyrtarë e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

I dërgohet:

- ❖ Drejtorit Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Krahësim dhe Verifikim të Pronës;
- ❖ Udheheqeses së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Krahësim dhe Verifikim të Pronës dhe,
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.